



UDHËZUES PËR PËRDORIMIN E CCTV



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

**PËRGATITUR NGA DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE
MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

QERSHOR 2013

PARATHËNIE.

Ky Udhëzues përmban rekomandime të përgjithshme që kanë për qëllim të orientojnë kontrollues të ndryshëm (publik ose privatë) në konceptimin dhe përdorimin e sistemeve të videosurvejimit, kamerat CCTV «closed-circuit television».

Përdorimi në mënyrën e duhur i sistemeve të survejimit përbën një mjet të fuqishëm në luftën kundër problemeve të ndryshme të sigurisë me të cilat përballemi në jetën e përditshme. Ndërsa, përdorimi në mënyrën jo të duhur të këtyre sistemeve çon shpesh në shkeljen e privatësisë dhe në kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Përmes përqaqjes dhe miratimit të programeve të bazuara në parimet e proporcionalitetit dhe selektivitetit, sistemet CCTV mund të plotësojnë nevojat e sigurisë duke respektuar njëkohësisht privatësinë tonë. Kamerat mund dhe duhet të përdoren në mënyrë të zgjuar dhe të synojnë vetëm identifikimin e qartë të problemeve të sigurisë, duke zvogëluar sa më shumë të jetë e mundur kapjen e imazheve të padobishme. Kjo përqaqje jo vetëm që zvogëlon shkeljet e mundshme të privatësisë tonë, por gjithashtu mundëson përdorimin e kamerave CCTV në mënyrë më efektive.

Duke respektuar parimet e vendosura nga Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, çdo kontrollues privat apo publik, ka të drejtë të zgjedhë mënyrën se si ta zhvillojë sistemin CCTV dhe në të njëjtën kohë duhet të tregojë ekzistencën dhe zbatimin e procedurave për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave personale. Në pikëpamjen administrative, këto praktika përfshijnë miratimin e garancive ndërmjet akteve nënligjore në fushën e të dhënave personale.

Përderisa përdorimi i kamerave CCTV vazhdon të gëzojë mbështetjen e publikut të gjerë, ai përfshin domosdoshmëri ndërhyrje në jetën e individëve të zakonshëm gjatë gjithë kohës. Praktika ka treguar se publiku pret që survejimi CCTV të përdoret me përgjegjësi, në përputhje me masat mbrojtëse efektive. Besimi i publikut në përdorimin e CCTV do të rritet në qoftë se do të ketë rritje të sigurisë dhe nëse të dhënat do të mbrohen, në mënyrë që të mos krijohet përshtypja e një shoqërie të mbikëqyrur.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale jo vetëm krijon detyrime për kontrolluesit, por ai gjithashtu u jep subjekteve të drejta të tilla si: të drejtën për të patur akses në të dhënat e tyre personale dhe për të kërkuar kompensimin në rast të përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale.

I. QËLLIMI I KËTIJ UDHËZUESI.

Ky Udhëzues është hartuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me kompetencat e dhëna në ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është për ti ofruar kontrolluesve publik dhe privat këshilla se si të përdorin sistemet e videosurvejimit në një mënyrë sa më të logjikshme dhe ligjore duke garantuar sigurinë e të dhënave personale.

Udhëzuesi i drejtohet personave që kanë vendosur të instalojnë ose jo sistemet CCTV dhe që janë përgjegjës për funksionimin e tyre pra “kontrollues” (sipas kuptimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave). Zakonisht bëhet fjalë për shërbimet e sigurisë nëpër institucione por gjithashtu dhe për hierarkinë vendimmarrëse të tyre. Ky Udhëzues ka për detyrë gjithashtu të orientoj furnizuesit ose kontraktorët e tjerë që përfshihen në instalimin dhe funksionimin e CCTV-ve, personat e ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave dhe subjektet e të dhënave personale.

Rekomandimet në këtë Udhëzues janë të gjitha të bazuara në parimet ligjore të mbrojtjes së të dhënave personale të cilat duhet të zbatohen nga përdoruesit e CCTV. Udhëzuesi pasqyron me shembuj konkret raste të përdorimit të CCTV por gjithashtu ngre disa pyetje të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga ana e kontrolluesve.

Ndjekja e rekomandimeve në këtë Udhëzues do të:

- ndihmojë për të siguruar që kapja e imazheve të individëve të jetë në përputhje me Legjislacionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- bëjë të mundur që imazhet e kapura të jenë të përdorshme; dhe
- sigurojë imazhet e subjekteve, të cilat do të përdoren nga ana e kontrolluesve.



II. FUSHA E ZBATIMIT E UDHËZUESIT.

Ky Udhëzues përfshin rregulla mbi përdorimin e CCTV dhe sistemeve të tjera të cilat kapin imazhe të individëve të identifikueshëm dhe informacion në lidhje me individët për ndonjë nga qëllimet e mëposhtme:

- Për të parë se çfarë është duke bërë një individ, (për shembull monitorimi i tyre në një dyqan apo ecja nëpër rrugë).
- Përdorimi i imazheve të një individ në një farë mënyre që do të ndikojë në privatësinë e tyre, (për shembull kalimin e imazheve drejt një kompanie televizive).
- Potencialisht për të marrë disa masa në lidhje me një individ, (për shembull dorëzimin e pamjeve policisë për të hetuar një vepër penale).

Shumica e CCTV-ve është e drejtuar në shikimin dhe regjistrimin e aktiviteteve të individëve. Kjo do të thotë se shumica e përdorimeve të CCTV-ve nga institucione apo biznese do të mbulohen nga Ligji i Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe përmbajtja e këtij Udhëzuesi, pavarësisht nga madhësia e sistemit.

Ky Udhëzues nuk do të aplikohet për aktivitetet e mëposhtme:

-thirrjet videotelefonike si dhe videokonferencat;

-sistemet e thjeshta të videove pa regjistrim;

- përdorimi i kamerave artistike ose gazetareske për qëllime të realizimit të një filmi ose regjistrimin e ngjarjeve personale (si psh festa ditëlindjeje);

- përdorimi i kamerave në mjedise shkencore laboratorike të kontrolluara, me kusht që kamera të regjistrojë imazhe vetëm të proceseve laboratorike (si psh: procese fizike apo kimike, dhe jo personat);

- përdorimi i kamerave për qëllime të kufizuara shtëpiake;

- pamjet e kapura për qëllime argëtuese, të tilla si me një telefon celular, aparat fotografik dixhital, ose videokamera, janë gjithashtu të përjashtuara.

Një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është dhe Video survejimi (CCTV). Përdoruesit e këtij mjeti konsiderohen se përpunojnë të dhëna me anë të këtij mjeti nëse përveç imazheve të kapura nga pajisjet video survejuese kanë regjistruar, ose grumbulluar informacione në pajisje regjistrimi dhe në të njëjtën kohë regjistrimet, ose informacioni i zgjedhur, shërben për identifikimin e individëve.

Të dhënat e ruajtura në sistemin e video survejimit, imazhe apo tinguj, janë të dhëna personale me kusht që një individ të mund të identifikohet drejtpërdrejtë apo tërthorazi në bazë të këtyre regjistrimeve. Një individ është i identifikueshëm, nëse imazhi në të cilën ai është regjistruar zbulon shenjat e tij dalluese si fytyrën, etj, dhe mundëson identifikimin e plotë të tij kur këto karakteristika krahasohen me të dhëna të tjera në dispozicion. Një e dhënë personale në tërësinë e

saj përbëhet nga ata faktorë identifikues që bëjnë të mundur lidhjen e një personi të caktuar me një sjellje të kapur nga një sistem video survejimi.

Një nga pyetjet që mund të lindë është: A aplikohen rregullat e këtij udhëzuesi në qoftë se imazhet nuk janë të regjistruara?

Përgjigja është Po. Kjo pasi edhe mbikqyrja ose shpërndarja direkte e imazheve është pjesë e fushës së zbatimit të këtij Udhëzuesi.

Siguria e të dhënave dhe respektimi i privatësisë mund të rrezikohen edhe në rastin kur nuk regjistrohen imazhet dhe në qoftë se ato transferohen direkt në një destinacion tjetër nëpërmjet një rrjeti të brendshëm. Ekziston mundësia që këto imazhe të interceptohen nga piratët informatik ose thjesht të përdoren për qëllime të tjera të jashtëligjshme nga personat që i marrin këto të dhëna.

Analizë e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale rekomandon që kontrolluesi në kuadër edhe të detyrimeve të parashikuara në Udhëzimin nr.21 dhe 22, datë 24/09/ 2012, para instalimit të sistemeve të kamerave CCTV, të kryejë një analizë të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave dhe jetën private. Qëllimi i kësaj analize është përcaktimi i ndikimit të sistemit CCTV në ruajtjen e sigurisë së të dhënave dhe privatësisë dhe gjithashtu të identifikojë mënyra të ndryshme për zbutjen dhe shmangien e efekteve të mundshme negative.

Për shkak të kompleksitetit, risive dhe reziqeve të qenësishme KMDP kërkon që analiza e ndikimit të përfshijë çështjet e mëposhtme:

- a) Qëllimet e tjera të përdorimit të videosurvejimit, përveç sigurisë;
- b) Si kryhet kontrolli mbi punonjësit (mënyrat dhe qëllimi);
- c) Përdorimi i webcam;
- ç) Kategoritë e të dhënave që mblidhen;
- d) Kontrolli që ushtrohet në kuadër të respektimit të jetës së tyre private;
- dh) Teknologjia e përdorur në videosurvejim;
- e) Sistemet e interkoneksionit (ndërlidhjes);
- ë) Mbikqyrja e fshehur (si funksionon);
- f) Regjistrimi zanor.

Analiza e ndikimit mund të kryehet nga vetë kontrolluesi ose nga një subjekt tjetër i jashtëm. Bazuar në analizën e kryer kontrolluesi mund të vendosë:

-të praktikojë mënyrën e kontrollit të parashikuar ose ta modifikojë atë.

-të zbatojë masa të tjera mbrojtëse përveç atyre të rekomanduara nga ky Udhëzues.

Analiza duhet të dokumentohet në mënyrë korrekte. Në parim analiza duhet të specifikojë në mënyrë të qartë rreziqet e mundshme në kuadër të respektimit të jetës private dhe të drejtave të tjera themelore.

III. BASHKËPUNIMI ME AUTORITETIN E MBROJTJES SË TË DHËNAVE (KMDP) DHE AKTORË TË TJERË

Kontrolluesi që synon përdorimin e CCTV duhet të konsultohet me aktoret dhe autoritetet kompetente me qëllim që të identifikojë të gjitha problemet e mundshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe në kuadër të zbatimit të politikave të nevojshme për mbrojtjen e këtyre të dhënave. Është i nevojshëm dhe i domosdoshëm konsultimi me autoritetet e mëposhtme:

-Personin e kontaktit/të ngarkuar;

-Përfaqesuesit e të punësuarve;

-Autoritetin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP).

Pra, sugjerohet që paraprakisht të merret mendimi i KMDP, për vendosjen e Sistemit të video survejimit (CCTV).

Projekti i instalimit ose përditësimit të sistemit CCTV duhet të hartohet në bashkëpunim me Personin e kontaktit i cili konsultohet në mënyrë sistematike me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Personi i kontaktit:

-duhet të marrë pjesë në vendimin fillestar për të përdorur apo jo CCTV.

-duhet të japë asistencën e tij në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale.

-mban lidhje të drejtpërdrejta me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe raporton sa herë kërkohet prej këtij të fundit/periodikisht.

KMDP rekomandon konsultimin me përfaqesuesit e të punësuarve (stafin) në të gjitha rastet kur përdorimi i sistemit të video survejimit (CCTV) synon përpunimin e të dhënave personale të tyre. Ky konsultim rekomandohet edhe në rastet kur përpunimi i mazheve nuk ka qëllim për të kontrolluar apo për të vlerësuar punën e stafit. Konsultimi mund të kryet me përfaqesuesit e të punësuarve ose në mënyrë të drejtëpërdrejtë me të punësuarit nëpërmjet konsultimeve publike apo seminareve të ndryshme (gje qe do te ishte edhe me efektive).

Vendimi për të përdorur sistemin e video survejimit duhet të jetë gjerësisht i argumentuar (duhet të dokumentohet me shkrim). Ai duhet të përmbajë të dhëna konkrete teknike, organizative dhe statistikore. Të dhënat statistikore duhet të saktësojnë numrin e incidenteve lidhur me mbrojtjen e sigurisë, të ndodhura përpara në të kaluarën, si dhe prova për efikasitetin e kamerave për të

parandaluar incidentet e mundshme gjithashtu dhe për të lehtësuar hetimin dhe ndjekjen penale pas këtyre incidenteve.

Disa nga pyetjet të cilave duhet t'u përgjigjeni për të vlerësuar nevojën e përdorimit të sistemit CCTV, janë:

-Cilat janë përfitimet e pritshme nga përdorimi i CCTV dhe a janë të mjaftueshme këto përfitime për të kompensuar efektet negative të tij?

-A është i specifikuar qartë qëllimi i sistemit dhe a është legjitim?

-A ka bazë ligjore (akt të brendshëm) për këtë?

-A është demonstruar qartë nevoja për të përdorur CCTV?

-A është CCTV mjete i duhur për të marrë rezultatin e pritshëm dhe a është alternativa e vetme për arritjen e qëllimit?

-A sigurohet një përpunim i drejtë i të dhënave personale në respektim të plotë të dispozitave ligjore në fuqi?

-A janë në dispozicion alternativa me pak ndërhyrese në të drejtat themelore?

Shkronja b) e pikës 4 të udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010, të ndryshuar, miratuar nga KMDP parashikon:

“Sistemi i video survejimit nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të individëve. Përpunimi i të dhënave me anë të një sistemi video survejimi mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër. Instalimi i një sistemi video survejimi është i ndaluar në dhoma që përdoren ekskluzivisht për qëllime private si tualete, dushe, zhveshje”.

Pra, Kontrolluesi duhet të vlerësojë mundësinë e një metode më pak ndërhyrese për të arritur objektivin e dëshiruar, pa pasur nevojë për përdorimin e kamerave. Nëse ekziston një alternativë tjetër adekuate, atëherë nuk këshillohet përdorimi i CCTV.

Përpara se të vendoset përdorimi i sistemit të video survejimit CCTV duhet që qëllimi :

1. Të specifikohet qartë dhe të jetë në përputhje me interesat ligjorë të kontrolluesit. Regjistrimet mund të përdoren vetëm për hetimin e një ngjarjeje që ka sjellë dëmtimin e këtyre interesave të mbrojtur me ligj. Legjitimiteti i përdorimit të të dhënave personale të regjistruara për qëllime të tjera duhet të jetë i kufizuar vetëm për një interes të rëndësishëm publik; (shkronja b) e pikës 4 të udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010, të ndryshuar, miratuar nga KMDP)
2. Ti komunikohet subjekteve të të dhënave. (shkronja dh) e udhëzimit të sipërpërmendur)
3. Komunikimi të bëhet në formë më të përmbledhur në vendin përkatës dhe në një formë më të detajuar p.sh në faqen zyrtare të kontrolluesit.

IV. VENDOSJA E KAMERAVE DHE KONFIGURIMI I SISTEMIT CCTV.

Ky Kre parashikon rregulla mbi vendosjen e kamerave, numrin e tyre, orarin e monitorimit, cilësinë e imazheve dhe konfigurimin e sistemit CCTV.

Parimi bazë është minimizimi i çdo ndikimi negativ në përputhje me privatsinë dhe të tjera të drejta dhe interesa të ligjshme të individit.

Në paragrafin 1) të pikës 5 të udhëzimit nr. 3, parashikohet se:

“Për përpunimin e të dhënave me anë të sistemit të video survejimit, duhet që lloji, specifikimet e kamerave dhe vendosja e tyre të jenë në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren. Kamerat nuk duhet të pozicionohen dhe të marrin imazhe nga ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes”.


Vendosja e kamerave CCTV dhe këndi i shikimit.

Kamerat duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mos regjistrojnë objekte të padobishme për qëllimin e synuar. Në përgjithësi, kur një sistem CCTV është instaluar për të mbrojtur pasuritë (mallrat ose informacionet) e kontrolluesit apo sigurinë e të dhënave, punonjësve dhe vizitorëve, kontrolluesi duhet të kufizojë monitorimin:

a.në vende të përzgjedhura me kujdes dhe që përmbajnë të dhëna personale ose sensitive, informacione të rëndësishme, sende me vlerë apo mallra të tjera që kërkojnë masa sigurie shtesë;

b.në pikat e hyrjes dhe daljes së objekteve (përfshirë daljet emergjente, dritaret, muret dhe gardhet përreth ndërtesës ose truallit) dhe;

c.në pikat e hyrjes dhe daljes brenda ndërtesës e nëpër zona të ndryshme me të drejta aksesimi të ndryshme dhe të ndara nga dyert e mbyllura apo nga një tjetër mekanizëm kontrolli.



Numri i kamerave të vendosura

Numri i kamerave të instaluar varet nga madhësia e ndërtesave dhe nevojat e sigurisë, të cilat vetë varen nga faktorë të ndryshëm. Numri dhe lloji i kamerave që i përshtaten një kontrolluesi

mund të jetë i ndryshëm në kontrollues të ndryshëm. Megjithatë, numri i kamerave është një tregues i mirë i kompleksitetit dhe madhësisë së një sistemi monitorimi dhe mund të tregojnë një rrezik në rritje në lidhje me privatësinë dhe të drejtat e tjera themelore. Rritja e numrit të kamerave gjithashtu rrit rrezikun që këto kamera të mos përdoren në mënyrë efektive dhe se sistemi i shkaktohet një mbingarkesë informacioni. Për këtë arsye KMDP rekomandon kufizimin e numrit të kamerave nëse nuk prek qëllimin e sigurisë.



Orari i monitorimit/regjistrimit

Orari i regjistrimit duhet të përfshijë vetëm periudhën e kohës kur ai është më efektiv dhe në interes të objektivit të synuar. Nëse qëllimi i regjistrimit është mbrojtja e sigurisë, sistemi duhet të rregjistrojë vetëm në atë periudhë kohe kur mundësia/rreziku për cënimin e sigurisë është më e madhe ose më e mundshme për të ndodhur.

Cilësia e imazheve

Cilësia e imazhit që kërkohet varion në funksion të qëllimit. Nëse identifikimi i individëve është i domosdoshëm, duhet të merren në konsideratë: rezolucioni i kamerave, sistemet dixhitale, vendndodhja, ndriçimi dhe faktorë të tjerë. Këto përcaktohen në mënyrë të tillë që të merren imazhe të cilësisë së mjaftueshme për të lejuar identifikimin e fytyrave të individëve.

CCTV e teknologjise së lartë dhe/ose “ inteligjente”

Përdorimi i mjeteve CCTV të “teknologjisë së lartë” ose “inteligjente”, në përgjithësi nuk rekomandohet deri në momentin që të realizohet një analizë e plotë ndikimi. Përdorimi i këtyre sistemeve i nënshtrohet gjithashtu një kontrolli paraprak. KMDP vlerëson rast pas rasti legjitimitetin e teknologjisë së përdorur dhe mund, nëse është e nevojshme, të imponojë garanci shtesë përsa i përket mbrojtjes së të dhënave personale.

Mjetet që i përkasin kësaj kategorie janë:

- a. Ndërlidhja e sistemit CCTV me të dhënat biometrike (për shembull, shenjat dixhitale të gishterinjve për efekt kontroll aksesi) ose me një bazë tjetër të të dhënave biometrike ose jo (për shembull, një bazë të dhënash fotografike të personave të dyshuar me qëllim që të arrihet identifikimi i tyre) etj;
- b. Rrjet kamerash të pajisura me një sistem ndjekës, i aftë të ndjekë objekte ose persona në zonën e caktuar të mbuluar nga rrjeti;
- c. Sistemet e alarmeve të bazuara në sinjale akustike (që aktivizohen nga zhurmat), kamerat me rreze infra të kuqe ose gjysem infra të kuqe dhe kamera të llojeve të tjera që janë në gjendje të filmojnë në erresirë ose përtej mureve, nën rroba (për shembull, skanerat e trupit) etj;
- d. Kamera të specializuara që janë në gjendje të zmadhojnë (zoom) optiken/pamjen.

Mjetet e mëposhtme, përkundrazi, nuk kanë nevojë për një analizë ndikimi ose një kontroll paraprak:

- a. Detektorët e lëvizjes që lejojnë limitimin e kapjes së imazheve që duhen vështruar dhe regjistruar;
- b. Konfigurimi i një sistemi të zbulimit të lëvizjeve, i aftë për të njoftuar personelin e sigurisë kur zbulon akses të paautorizuar në një zonë të kufizuar;

c. Pajisje me kapacitet normal, që kryejnë skanim horizontal dhe vertikal, dhe zmadhim numerik.

V. KOHEZGJATJA E RUAJTJES SE IMAZHEVE DHE REGJISTRIMI


Parime të Përgjithshme

Shkronja c) e pikës 4 të udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010, të ndryshuar, miratuar nga KMDP, parashikon:

“Periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video survejimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video survejimit do të ruhen për një periudhë **deri në dy muaj** dhe pas kalimit të kësaj periudhe të dhënat do të fshihen. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë regjistrimet e bëra nga policia në përputhje me legjislacionin e veçantë.”

Është e këshillueshme që fillimisht të shtrohet pyetja nëse regjistrimi është i nevojshëm, apo një mbikqyrje direkte do të ishte e mjaftueshme. Në qoftë se kontrolluesi përkates zgjedh të regjistrojë imazhet duhet të përcaktojë saktësisht kohëzgjatjen e ruajtjes së tyre (*pa tejkaluar afatin ligjor të përcaktuar*) dhe në momentin që mbaron kjo kohe, regjistrimet duhet të fshihen.

Në qoftë se CCTV përdoren për qëllime sigurie apo kontroll aksesi, në momentin që ndodh një incident sigurie dhe regjistrimet duhet të shërbejnë në cilësinë e provës, atëherë pjesët/pasazhet përkatëse të imazheve mund të ruhen përtej kohëzgjatjes normale por duhet të fshihen në momentin kur mbaron shqyrtimi i tyre.



Periudha ruajtjeje më të shkurtra

KMDP rekomandon periudha ruajtjeje më të shkurtra ose një mbikqyrje direkte vetëm në rastet kur kjo marrje mase është e nevojshme për të reduktuar në minimum impaktin mbi respektimin e

jetës private, të drejtave të tjera themelore dhe interesave legjitime të personave që “kalojnë“ pranë fushës së vizionit/pamjes të kamerave.

Regjistri i regjistrimeve i ruajtur përtej kohëzgjatjes normale

Kontrolluesi përkatës duhet të mbajë një regjistër regjistrimesh (nëse është e mundur në formë elektronike), ku të pasqyrohen të gjitha regjistrimet dhe të dhënat personale të ruajtura përtej periudhës normale.

Ky regjistër duhet të përmbajë:

- datën dhe orën e imazhit të regjistruar dhe vendodhjen e kamerës;
- kategoritë e të dhënave personale të ruajtura;
- një përshkrim të shkurtër të incidentit të mundshëm;
- arsyeja dhe qëllimi i plotë për të cilën është ruajtur;
- datën në të cilën imazhi ose e dhëna do të fshihet.

VI. PERSONAT E AUTORIZUAR PËR AKSESIN E IMAZHEVE DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Aksesi në sistem dhe në imazhe i duhet rezervuar një numri të kufizuar personash. Gjithashtu duhet që përdoruesit e autorizuar të mund të kenë akses vetëm te ato të dhëna personale që i korrespondojnë të drejtës së tyre të aksesit. Kjo do të thotë që përdoruesit duhet të kenë akses vetëm në informacione dhe të dhëna që janë të detyrueshme për përfundimin e punës së tyre.

Politika e sigurisë së informacionit dhe rregullat e brendshme mbi funksionimin dhe përdorimin e sistemit CCTV duhet të specifikojnë dhe dokumentojnë në mënyrë të qartë personat që kanë akses në mbikqyrjen e imazheve gjithashtu dhe arsyen e aksesit dhe natyrën e aksesit. Gjithashtu duhet të specifikohen në mënyrë të plotë personat që kanë të drejtë të kontrollojnë imazhet, personat që janë përgjegjës për ruajtjen e sigurisë teknike dhe ata që trajtojnë rastet e incidenteve të ndryshme.



VII. TRAJNIMI I PERSONELIT DHE MBROJTJA E KONFIDENCIALITETIT

Trajnimi

Trajnimi i personelit të kontrolluesit duhet të kryhet në përputhje me përcaktimet e bëra në Kapitullin IV “Trajnimi i personelit të Subjektit Përpunues të të Dhënave Personale” të Udhëzimit nr. 21, datë 24/09/ 2012 për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj”.

Kontrolluesi siguron trajnim profesional për Personin/at e Kontaktit/të ngarkuar të caktuar prej tij dhe për personelin që akseson të dhënat personale. Komisioneri mund t'i kërkojë kontrolluesit të sigurojë prova për zhvillimin e trajnimit profesional.

I gjithë personeli që ka të drejtë akses, duke përfshirë dhe ata që operojnë nga jashtë dhe që janë të ngarkuar për mirëmbajtjen teknike të sistemit apo dhe veprime të tjera, duhet të trajnohen lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale gjithashtu dhe mbi rregullat e parashikuara në këtë

Udhëzues. Përveç rasteve të parashikuara në udhëzimin nr.21, trajnimi duhet të organizohet gjatë instalimit të sistemit CCTV, në rast modifikimesh të rëndësishme të një sistemi CCTV ekzistues ose për personat e punësuar rishtazi.

Konfidencialiteti

Të gjithë personat që janë pjestarë të personelit të kontrolluesit që kanë të drejtë aksesit në të dhënat personale dhe të gjithë personat e autorizuar duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti në të cilën marrin përsipër të mos transferojnë, përhapin apo publikojnë në asnjë mënyrë të dhënat e përpunuara nëpërmjet sistemit të video survejimit.

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit është parashikuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe shkronjën h) të pikës 4 të udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010, të ndryshuar.

VIII. MASAT E SIGURISË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

Analiza e riskut

Në fillim, duhet të kryhet një Analizë e riskut nëpërmjet të cilës të identifikohen rreziqet e ndryshme të sigurisë në mënyrë që të përcaktohen masat e sigurisë, të nevojshme për të mbrojtur sistemin CCTV, përfshirë të dhënat personale që ai përmban.

Detyrimi për hartimin e Analizës së riskut parashikohet në pikën 21, të Udhëzimit nr. 21, Datë 24/09/ 2012 të përmendur më lart.

Në të gjitha rastet, duhet të merren masa mbrojtëse për të garantuar sigurinë e të dhënave në çeshtje si:

- transmetimi;
- përhapja;
- transferimi ndërkombëtar;
- magazinimi (për shembull në një bazë të dhënash kompiuterike);
- aksesi (për shembull aksesit në sistemet kompiuterike).

Transmetimi i të dhënave duhet të kryhet me mjete të siguruara nga përgjimi. Mbrojtja kundër përgjimit është veçanërisht e rëndësishme në rast se përdoret një sistem transmetimi pa kabëll ose në rast transmetimi nëpërmjet internetit. Në këto raste të dhënat duhet të kodifikohen gjatë transmetimit ose të kenë një mbrojtje ekuivalente (me mjete të tjera teknike).

Të gjitha mjetet e përdorura për ruajtjen apo aksesimin e të dhënave të përpunuara nëpërmjet sistemit të video survejimit duhet të sigurohen. Aksesit fizik në dhomën e kontrollit dhe në dhomën

e magazinimit duhet të mbrohet. Asnje palë e tretë (p.sh. personel apo mirëmbajtjes) nuk duhet të ketë mundësinë për të hyrë në ambientet e përpunimit të të dhënave, i pambikqyrur.

Analiza e sigurisë dhe masat e marra për të mbrojtur të dhënat, duhet të dokumentohen dhe duhet të bëhen sipas dispozitave nënligjore të miratuara nga KMDP.

Shkronja d) e pikës 4 të udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010, të ndryshuar, miratuar nga KMDP, parashikon:

“Të dhënat personale të mbahen të sigurt dhe të mos keqpërdoren apo korruptohen në ndonjë mënyrë. Siguria nuk ka të bëjë vetëm me marrjen e masave fizike, me gjithëse këto janë shumë të rëndësishme. Siguria gjithashtu ka të bëjë me organizimin e punës në një mënyrë të tillë që risku të minimizohet, për shembull duke siguruar që personeli të mund ti shohë të dhënat vetëm kur kjo është e nevojshme që ata të kryejnë punën e tyre në mënyrën e duhur dhe duke e trajnuar personelin në lidhje me çfarë duhet dhe nuk duhet të bëjë.”

Së fundi, kontrolluesi duhet të tregojë kujdes të veçantë në zgjedhjen dhe kontrollin e personelit të jashtëm.

Transmetimi në autoritetet kombetare

Shpesh herë lind nevoja që të dhënat e siguruar nga sistemet e video survejimit t'i komunikohen policisë, gjykatave apo autoriteteve të tjera shtetërore. Nëse këto organe kërkojnë shqyrtim të një regjistrimi apo të dhëne të caktuar, kjo duhet të justifikohet vetëm nëpërmjet një kërkesë me shkrim të bazuar në një parashikim ligjor. Kjo kërkesë duhet të specifikojë arsyen/qëllimin pse kërkojnë regjistrimet apo të dhënat, bazën ligjore përkatëse, gjithashtu dhe vendin, orën, datën e sekuenca filmike të kërkuar.

Kontrolluesit duhet të disponojnë regjistra transferimesh dhe rishqyrtimesh të regjistrimeve dhe të dhënave të tjera, mundësisht në format elektronik.

IX. INFORMIMI I PUBLIKUT

Informimi i publikut lidhur me video survejimin duhet të bëhet në mënyrë të plotë dhe efikase. Ky Udhëzues rekomandon dy metodat e mëposhtme:


a. Njoftim të afishuar në formë posterit nëpër ambiente të ndryshme. Kjo mundëson informimin direkt të publikut për video survejimin dhe përmban gjithashtu informacionet më të rëndësishme të lidhura me trajtimin e të dhënave.

b. Njoftim të detajuar për mbrojtjen e të dhënave, publikuar në faqet zyrtare në internet të kontrolluesit (i disponueshëm për të gjithë ata që duan të informohen në mënyrë të detajuar).

E drejta e informimit të subjektit të të dhënave është sanksionuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe në

shkronjën dh) të pikës 4 të Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010, të ndryshuar, miratuar nga KMDP, në të cilin parashikohet:

“Subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem të video survejimit është në veprim, duke vendosur njoftimin e shkruar në hapësirën e monitoruar me përjashtim të rastit kur një e drejtë e veçantë dhe detyrimet që rrjedhin nga një ligj i veçantë janë duke u ushtruar.”



Njoftimet e afishuara në ambientet e survejuara

Në ambientet që janë nën vëzhgimin e kamerave (CCTV) duhet të vendosen njoftime (shenjat e dukshme permanente) në një vend lehtësisht të dukshëm (**parimi i transparencës**). Subjekti i të dhënave duhet të jetë i vetëdijshëm që ai ose ajo po hyn në një zonë të vëzhguar.

Njoftimet duhet të përmbajnë:

- identifikimin e përgjegjësit të sistemit të video survejimit (zakonisht emri i kontrolluesit është i mjaftueshëm);
- qëllimin e vëzhgimit (zakonisht “për sigurinë dhe shëndetin tuaj” është e mjaftueshme);
- saktësimin nëse imazhet do të regjistrohen apo jo;

- numër kontakti apo adresë interneti ku individët mund të informohen mbi politikat e video survejimit (CCTV);

- Nëse CCTV do të prekë dhe ambiente të tjera jashtë ndërtesës së caktuar. (Kjo duhet të saktësohet sepse një njoftim i tipit “ndërtesa përben objekt videosurvejimi”, lë hapsirë për tu keqkuptuar).

Këto njoftime duhet të pozicionohen nëpër vende të përshtatshme dhe të kenë një format të mjaftueshëm, në mënyrë të tillë që personat përkatës të mund ta venë re përpara së të hyjnë në zonat e survejuara, dhe të mund ta lexojnë pa asnjë lloj vështirësie. Kjo nuk do të thote që është e detyrueshme të afishohet një njoftim përbri çdo kamere të vendosur.

Politika e vëzhgimit me kamera në internet (CCTV online)

Për të bërë të mundur një njoftim sa më të plotë të publikut në kuadër edhe të mbrojtjes së të dhënave personale, duhet që politikat e vëzhgimit me kamera, të publikuara në internet, të përmbajnë informacionet e mëposhtme (në një format lehtësisht të lexueshem):

- Identitetin e përgjegjesit të sistemit të video survejimit (emrin e kontrolluesit p.sh: emrin e institucionit, drejtoria e përgjithshme ose drejtoria përkatëse.);
- Një përshkrim i shkurtër i zonave që do të mbulojnë nga CCTV (psh: hyrjet dhe daljet, dhomat e kompjuterit, dhomat e arkivit etj.);
- Bazat ligjore (akte të brendshme) për video survejimin (CCTV);
- Të dhënat e mbledhura dhe qëllimi i video survejimit (çdo kufizim në përdorimet e lejuara duhet gjithashtu të përcaktohen qartë);
- Personat që kanë akses në pamjet/sekuenca/pjesët filmike si dhe kujt mund t’i zbulohen pamjet;
- Mënyra dhe masat se si do të ruhen dhe mbrohen informacionet;
- Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave;
- Procedurat që duhet të ndjekin subjektet e të dhënave për të verifikuar, ndryshuar apo fshirë informacionet e tyre;
- Të drejtën për t’iu drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMPD) në çdo kohë.

Përveç kësaj, politika e vëzhgimit me kamera duhet të ofrojë lidhje me:

- Udhëzuesin e Komisionerit për vëzhgimin me kamera,
- Raportet e kontrollit të institucionit,
- Raportet e vlerësimit të ndikimit të institucionit, dhe

X. TRAJTIMI I KËRKESAVE PËR AKSES NGA ANA E PUBLIKUT/SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Çdo individ gëzon të drejtën e aksesit në të dhënat e tij personale. Kjo nënkupton se kur individ i kërkon të dhënat e tij personale që janë përpunuar nga kontrolluesi, ky i fundit ka detyrimin që ti përgjigjet në kohën e duhur dhe në detaje lidhur me çdo shqetesim të tij.

Në qoftë se kemi të bëjmë me një kërkesë të përgjithshme, mjafton që personit ti bëhet e qartë politika e vidosurvejimit. Ndërsa për kërkesat më specifike nevojitet një trajtim në mënyrë më të detajuar që përfshin dhënien e aksesit në imazhet ku ai shfaqet (të dhënat e tij personale) duke errësuar imazhet e personave të tretë (e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale e të cilëve çënohet nëse këto imazhe aksesohen nga një person i tretë i paautorizuar).

Mbrojtja e të drejtave të palëve të treta nuk duhet të përdoren si arsyetim për të ndaluar kërkesa legjitime për akses nga ana e individëve, në veçanti, atje ku regjistrimet janë përdorur si dëshmi.

E drejta për akses në të dhënat personale parashikohet në nenin 12 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Gjithashtu, parashikohet edhe në shkronjën e) të pikës 4 të Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010, të ndryshuar, miratuar nga KMDP,:

“Në këtë kuadër duhet të garantohen edhe të drejtat e tjera të subjektit të të dhënave personale, psh, e drejta që të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave.”

XI. PËRGJEGJËSITË

Sigurimi, verifikimi dhe administrimi i mirë i të dhënave personale

Kontrolluesit duhet të adaptojnë politika dhe procedura për të siguruar që përdorimi i CCTV (vëzhgimin me kamera) është konform me ligjin. Për këtë arsye KMPD rekomandon çdo kontrollues që :

- të miratojë një politikë video survejimi;
- të kryejë audite të brendshme (kontrolle) periodike për të dokumentuar rezultatet në raportet e tyre.

Politika e vëzhgimit me kamera

Politika e vëzhgimit me kamera duhet:

- a) të paraqesë një pasqyrë të sistemit të vëzhgimit me kamera (CCTV) dhe të përshkruajnë qëllimet e tij;
- b) të përshkruajë përdorimin e sistemit, përdorimin që i bën të dhënave personale dhe masat e sigurisë;

- c) të specifikojë konfirmimin e pajtueshmerisë me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe udhëzimet e miratuara nga KMDP;
- d) të përshkruajë dallimet nga praktikat standarde të rekomanduara në udhëzues dhe nga udhëzimet përkatëse, dhe të shpjegojë arsyet.
- e) të përshkruajë masat e zbatuara.

Politika e vëzhgimit me kamera (CCTV) është një dokument që ndjek disa qëllime. Ajo duhet ti përgjigjet kërkesave të mëposhtme:

- a) Miratimi i këtij dokumenti do të jetë i nevojshem për të plotësuar dhe sqaruar bazën ligjore, dhe kështu për të vendosur legjitimitetin e vëzhgimit me kamera (CCTV).
- b) Vendosja e praktikave më të mira në shkrim dhe planifikimi i masave të tjera të nevojshme për të zbatuar, që do të përmirësojnë procedurat dhe do të sigurojnë pajtueshmëri më mirë.

Së fundi, duke forcuar transparencën dhe duke treguar përpjekjet e tyre për pajtim me ligjin, institucionet duhet të krijojnë besimin e punonjësve të tyre dhe palëve të treta, të ndihmojnë në lehtësimin e konsultimit me grupet e interesit dhe të lehtësojnë nderveprimet me KMDP.

Institucionet duhet të publikojnë politikat e tyre të videosurvejimit në faqet e tyre në internet. Në qoftë se dokumentat kanë përmbajtje informacionesh konfidenciale, atëherë duhet të bëhet publik një version jokonfidencial.